- 43.1 Kontraktori nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 44:
Sigurimi i Kontrates

- 44.1 Brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për fitimin e kontratës, kontraktori duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën dhe formën e pranueshme siç specifikohet në kontratë. Dështimi për të dhene sigurimin e kontrates në formën dhe në shumën e kërkuar brenda 30 ditëve do të rezultojë në anulimin e kontratës dhe humbjen e sigurimit të Ofertës të kontraktorit.
- 44.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktori në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.



44.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.

**Neni 45:
Baza Ligjore**

45.1 Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 46:
Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

- 46.1 Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.
- 46.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 47:
Përfaqësimi i Palëve**

- 47.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukturë organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.
- 47.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 47.3 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

**Neni 48:
Lajmërimet**

- 48.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetër sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.
- 48.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 49:
Llogaritja e Afateve**

- 49.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.



II. KUSHTET E VEÇANTA

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast se do të ndodhë ndonjë konflikt, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë ato të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 1: Përkufizime

- 1.1 Autoriteti Kontraktor është: **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- 1.2 Kontraktori është: bashkimi i operatorëve ekonomik **“Harmonia” sh.p.k. dhe “GPG Kompani” sh.p.k**

Neni 2: Sigurimi i Kontrates

- 2.1 Sigurimi i kontrates në shumën prej **11,414,353 (një milion katërqind e katërbëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e tre) Lekë (10% të vlerës së ofertës)** duhet të ofrohet nga kontraktori për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 2.2 Sigurimi i kontrates do t’i lëshohet ose kthehet, menjëherë, kontraktorit sipas skedarit të mëposhtëm: në fund të kontratës.

Neni 3: Drejtuasi i Projektit

- 3.1 Drejtuesi i Projektit do të jetë: Supervizori

Neni 4: Kantieri

- 4.1 Kantieri i Punëve do të jetë (Pershkrimi i saktë i venddodhjes së objektit që do të realizohet):

Neni 5: Data e Fillimit

- 5.1 Kontraktorit do t’i jepet leja për të hyrë në kantier: Jo më vonë se 30 ditë pas nënshkrimit të kontratës.

Neni 6: Siguracioni

- 6.1 Nga data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion që mbulon deri në shumën prej:



- a. Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve: 100% e vlerës së Kontratës
- b. Për dëmtime ose humbje të Pajisjeve: 1,000,000 Lekë
- c. Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Punëve, Materialeve dhe Pajisjeve: 1,000,000 Lekë
- d. Për dëmtim personal ose vdekje të personave në kantier: 500,000 Lekë

**Neni 7:
Inspektimet dhe Testimet**

7.1 Inspektimet dhe testimet para vërtetimit të mbarimit të Punëve do të përfshijnë: _____

**Neni 8:
Lloji i Kontratës**

8.1 Kjo kontratë do të çmohet si një: Kontratë me Çmim Njesie të bazuar në çmimet e njësisë të shprehura në Preventivin në Njësi.

**Neni 9:
Grafiku i Pagesës**

- 9.1 Pagesa duhet bërë sipas grafikut të mëposhtëm: sipas situacioneve periodike
- 9.2 Pagesa për Punët duhet bërë brenda 28 ditëve nga data që kontraktori paraqet një dokument që deklaron se objektivi për pagesën është arritur subjekt ky i konfirmimit të dokumentit nga drejtuesi i projektit.
- 9.3 Monedha e pagesës do të jetë Lek.

**Neni 10:
Pagesa Paraprake**

10.1 Kontraktori do të marrë pagesë paraprake në vlerën 10% të vlerës së Kontratës, kundrejt dhënies së një garancie të pranueshme për AK, në vlerë dhe monedhë të njëjtë me pagesën paraprake. Garancia e paradhënies do të jetë e vlefshme deri sa pagesa e paradhënies të jetë shlyer plotësisht, por vlera e garancisë mund të reduktohet në mënyrë progresive me të njëjtën shumë të shlyer nga Kontraktori, me kërkesën e tij.

10.1 Pagesa e paradhënies do të shlyhet duke reduktuar vlerat e pagesave periodike në masën 10 %.

10.2 Kushtet e veçanta të mëposhtme do të zbatohen për kryerjen e pagesës së Shërbimeve të lidhura.

**Neni 11:
Zbritja e garancisë së kontratës**

11.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.



II. DISPOZITA TE FUNDIT

1. Kjo kontratë hartohet në 2 kopje, siglohet në çdo faqe, firmoset dhe vuloset në faqen e fundit nga të dy palët.
2. Kjo Kontratë përbëhet nga 5 Anekse
 - a) Aneksi 1 – Specifikimet teknike
 - b) Aneksi 2 – Preventivat
 - c) Aneksi 3 – Grafiku i punimeve
 - d) Ankesi 4 – Projekti
 - d) Aneksi 5 – Sigurimi i kontratës



Specifikimet Teknike



SPECIFIKIMET TEKNIKE-UJESJELLES

1 Udhezime per Instalimin, Operimin dhe Mirembajtjen

Kontraktori do te dorezoje manuale ne Shqip per instalimin mirembajtjen dhe operimin e paisjeve.

2 Standartet

Materialet dhe paisjet do te jene sipas standarteve kombetare ose nderkombetare te aprovuara. Te gjitha materialet dhe komponentet perberese do te jene te certifikuara sipas Standarteve Kombetare te nje Vendi Anetar te Bashkimit European, ose te Vendit dhe te gjitha prodhimet do te jene konform Standarteve Kombetare te ngjashme ose Kodet ne Praktike. Standartet Angleze dhe Kodet e Praktikuara jane kuotuar ne kete dokument por ekuivalent ISO, DIN, UNI, Standarte te Vendeve ose Shteteve Anetare mund te jene te pranueshme. Kontraktori mund te propozoje standarte alternative kombetare sic jane specifikuar; nje kopje te alternativave te propozuara duhet ti paraqiten Supervizorit per rishikim dhe aprovim. Nje kopje te gjithe standarteve te aprovuara do te mbahen ne Kantier nga Kontraktori. Nqs nuk ka Specifikime te Standarteve te publikuara, materialet dhe prodhimet do te jene nga standartet me te mira te pershtatshme dhe do te jene subject per aprovim nga Drejtuesi I Punimeve. Kur punimet e propozuara lidhen me paisjet ekzistuese materialet e reja do te jene te pershtatshme me ato ekzistueset. Simbolet per njesite e matjeve konform me Sistemin Internacional (SI) sistem I vendosur ne BS 5775/93 (ISO 31/92).

3 Mbrojtja dhe Paketimi per Transport

Perpara dergimit prej fabrikes te gjitha paisjet do te jene te mbrotjura mjaftueshem prej lyerjes ose nga menyra te tjera te aprovuara per te gjithe periudhen e tranzitit, magazinimit, mbrojtje nga korrozioni dhe demtime aksidentale. Kontraktori do te jete pergjegjes per paketimin nga fabrika, per mbrojtjen ne menyre qe materialet te arrine ne vend te pa demtuara.

4 Keshilla per Transportin

Kontraktori do ti dergoje keshillat e transportit Drejtuesit te Punimeve. Ky informacion duhet te dergohet dy jave para se materialet te jene nisur per transport.

5 Magazinimi ne vend dhe mbajtja ne menyre te sigurte

Drejtuesi I Punimeve do te jete dakort mbi daten e shperndarjen te makinerive me transportin e meparshem te Kontraktorit.

Ne rast vonesa te programit te Punes, Kontraktori do te udhezohet nga Supervizioni:



- 1) Paketim I mjaftueshem per te gjithë materialet e listuara te Fabrikes ku te jete e mundur qe materialet qe do te magazinohen te hapura ne vend te mos demtohen.
- 2) Sigurimi I nje magazine te aprovuar, duke zbatuar kerkesat minimale te vendit per parandalimin e demtimeve te paisjeve si me poshte:
 - Paisjet Elektrike: te mbuluara, ajer I kondicionuar, mbrojtje nga pluhuri dhe mbrojtje nga parazitet.
 - Makinerite mekanike: siperfaqe e mbuluar.
 - Tubat, saracineskat, punimet e celikut etj.: te vendosura ne zona te hapura te qendrueshme. Llamarinat qe do te perdoren te jene te tipit qe nuk demtohen nga drita e diellit.

6 Inspektimi I vendit

Perpara pergatitjes per fillimin e punimeve (nqs kerkohet) Kontraktori do te vizitoje ne vend dhe do te verifikojë gjendjen e tij aktuale perkundrejt vizatimeve te pergatitura, do te kontrolloje te gjithë dimensionet, kushtet e vendit dhe kerkesave dhe do te siguroje qe te gjithë materialet I plotesojne kerkesat e Kontrates.

7 Shkarkimi, Ndertimi dhe Operimi

Kontraktori sipas Kushteve te Kontrates do te beje organizimin per shkarkimin e paisjeve te furnizuara ne vend ose magazinimin dhe eshte pergjegjes per ndonje demtim. Kontraktori do te siguroj me shpenzimet e tij te gjithë paisjet, veglat matese, garazhdet, akomodimin e perkohshem, punetoret e kualifikuar dhe te pakualifikuar per ngritjen e te gjithë paisjeve dhe aparateve qe do te instalohen dhe ti dorezoje ato ne gjendje pune te mire.

Perpara fillimit te punes Kontraktori do te ekzaminoje strukturat dhe te beje organizimin me Supervizionin qe paisjet te instalohen pa nderhyrje me punet ne vazhdim te konstruksionit dhe mund te shperndaje ne vend te gjitha materialet e listuara te kerkuara.

Kontraktori duhet te parashikoj ngritje kantieri, Kontraktori duhet te perfshije kete ne cmimin e kontrates.

Kontraktori do te instruktrohet nga stafi I Supervizionit, I cili mund te jete emeruar per te marre ngarkesat ne te gjitha ceshtjet dhe gjerat qe kane te bejne me operimin, rregullimin dhe mirembajtjen e paisjeve ne kushte te pershtatshme.

8 Dorezimi i Tubave

Gjate ngarkimit, transportit dhe shkarkimit duhet te tregohet kujdes per parandalimin e demtimit te tubave dhe ruajtjen e veshjes, nqs ka. Ngarkimi dhe shkarkimi do te behen ngadale nga punetore te afte dhe paisje ngritese te fuqishme, te nevojshme. Tubat do te jene nen kontroll te rrepte gjate gjithë kohes. Kur shkarkohen tubat me vinc duhet te vendosen derrasa rrotull tubave.

9 Punime ne mot te ftohte

Asnje material nuk duhet te futet ne punime me kondita me ngrice, por do te ruhet ne objekt dhe do te perdoren me vone ne se eshte e pershtatshme kur te shkrije me aprovimin e inxhinerit.

Shtrimi I betonit do te ndalohtet kur temperaturat e ajrit zbresin nen 3°C dhe nuk do te rifillojne deri sa temperatura e ajrit ne hije te arnie ne 3°C .

10 Mbrojtja nga Uji

Kontraktori do te jete pergjegjes dhe perballoje te gjitha koston direkte dhe jo direkte ne lidhje me ujin, pavaresisht se eshte nga tubat ekzistuese ose nga sistemet e kanaleve, liqeneve, lumenjve. rrjedhjet ujore. burime nentokesore, rreshjet ose ndonje shkak ose burim tjetet. Kontraktuesi do te mbaje te gjitha vepren te lire nga uji dhe do te siguroje te gjitha digat, argjinaturat, pompimet, pilotat, mbrojtjen e brogjeve, drenazhet prazore, pusetat etj, te nevojshme per kete qellim. Kontraktori me shpenzimet e tij, do te marri te gjitha masat per te ndaluar demet ne saj te erozionit dhe nga depozitimet e aluvioneve gjate ndertimit. Nese akumulohet ndonje uje ne ndonje pjese te vepres si gjate ndertimit ashtu dhe pas saj, deri ne fund te periudhes se garancise, duke shkaktuar kondita lageshtie ose erozioni, Inxhinieri mund te urdheroje kontraktin te heqe dhe zevendesoje, me shpenzimet e kontraktorit, çdo material ose veper qe eshte ndikuar. Cdo demtim e vepres ose i pronave ne kufi qe rezulton nga deshtimi i kontraktorit ne marrjen e masave te nevojshme parandaluese do te riparohet me shpenzimet e kontraktorit.

11 Shmangia e sherbimeve ekzistuese

Menjehere pasi kerkesa eshte e bere e njohur, kontraktori do te jete pergjegjes per organizimin, ne bashkeveprim me autoritetet perkatese, per levizjen ose alterimin (ndryshimin) e sherbimeve ekzistuese te tilla si linjat elektrike dhe telefonike, linjat kryesore te ujit te pijshem, tubacionet, kanalet ujites, kanalizimet e ujrave te zeza dhe drenat e ujit siperfaqesore te cilat ndikohen nga vepra. Organizimi per nje levizje ose alterim (ndryshim) te tille do te jete me kusht te renies dakord me Inxhinierin dhe me autoritetet perkates ne zerat e cmimeve te preventivit; ne kete kuader devijimi i sherbimeve ekzistuese nuk do te jete subjekt i ndryshimit te çmimit total te kontrates.

12 Materialet dhe Fuqia punetore . Tubacionet

12.1 Tubacionet dhe Aksesoret

Te gjitha materialet, punimet e tokes, shtrimi, lidhjet dhe rakorderite dhe prova e tubacioneve do te plotesojne me detaje te gjitha kerkesat e ketij Specifikimi Teknik. Te gjitha materialet duhet te jene te reja dhe te paperdorura; te gjitha tubat dhe rakorderite duhet te jene te inspektuara me kujdes, ne kohen qe arrijne ne objekt nga Kontraktori. Cdo material me difekt duhet te vendoset menjane per inspektim nga Supervizori; ato duhet ose te riparohen ose te zevendesohen sipas instruksionit te dhene nga Drejtuesi i Projektit.



12.2 Standardet per Materialet e tubave PE dhe Aksesoret

Te gjitha produktet PE do te jene sipas standarteve DS2119, DIN8074/75, EN 12201-1,2 dhe 5. Eshte pergjegjesia e kontraktorit qe te gjitha tubat qe vendosen brenda strukturave te godinave dhe puseve te vendosen korrekt per lidhjen e tubacioneve dhe paisjeve ne godine dhe puse. Te gjitha tubat me diameter me te madh se 90 mm do te prodhohen me material PE100 dhe te gjitha tubat me diameter me te vogel se 75mm do te prodhohen me material PE80.

Tubat PE80 do te prodhohen sipas DS 2119 dhe DIN 8074-8075 dhe te gjitha tubat PE100 do te prodhohen sipas EN 12201-1,2 dhe 5.

Te gjitha tubat PN6,3 me diameter me te madh se 90 mm do te jene SDR26 dhe te gjitha tubat PN10 me diameter me te madh se 90 mm do te jene SDR17.

Ciftet Electro fusion do te jene sipas standarteve DS SBC 218, DS 2131.2.

Kontraktori do te paraqese per te gjitha materialet certifikaten e origjines dhe te materialeve dhe standarteve.

12.3 Saldimi I tubave PE

Per bashkimin e tubave dhe aksesoreve me saldimit do te aplikohet saldimi ose **bashkimi me elektro fusion**. Kur aplikohet saldimi me elektrofuzion te gjitha tubat e terhequr do te perfshihen ne bashkimin me electro fusion.

Kontraktori do te paraqese te Drejtuesi i Projektit per aprovim parametrat e saldimit dhe dokumentacionin e makinerive te tij te saldimit.

12.4 Dorezimi I tubave PE

Kontraktori do te ndjeke udhezimet e meposhtme per dorezimin dhe magazinimin e tubave PE:

- Paketimi dhe magazinimi per transport
- Ngarkimi dhe shkarkimi i tubave
- Kushtet e magazinimit dhe lartesia e depozitimit
- Shtrati I tubave

12.5 Provat e presionit te tubave

Prova me uje te pakten 1.3 x PN (bar). Prova sipas standarteve SFS 3115:E.

13 Komponentet

13.1 Saracineskat e Ajrimit

Te ngjashme me ato te prodhuara Danfoss, tipi Socla VE320.

Te mbi tubacione per montim te saracineskave te ajrimit do te kene te njejtin dimension me ate te tubave. Saracineskat e ajrimit do te montohen me flanaxhe lidhese me saracineske bllokimi per

mbylljen e saracineskes se ajrimit.

Materiali I saracineskave

- Saracineskat e shtepive gize GGG40
- Float ne polyester
- Sistemi mbylles PVC
- Spindle nylon
- Float seat in polyurethane
- Saracineska drenimit AISI304
- Mbulesa siper celik DIN 1629/3
 - Valve seat in nitrile rubber
 - Mbulesa saracineskes gize GG25
 - Saracineska bllokimit brass
 - Float *fixing* and float guide in GGG40
 - Siperfaqja jashte I brenda me polyester

13.2 Saracineska

Saracineskat duhet te kene nje bire ne qoshe per portat ne fund te saracineskes me qellim shmangien e papastertive neper qoshe. Spindle duhet te jene me unaze me celik i pandryshkshem.

Flanxhat dhe birat sipas DIN2501. Provat sipas ISO 5208, seat 1.1 x PN dhe trupi 1.5 x PN. Aprovuar nga DVGW ose te ngjashem.

Materialet

Trupi hekur i farketueshem, GGG40 to BS2789 ose D[N 1693

Veshja Electro statically aplikuar me epoxy resin sipas DIN 30677

Spindle celik i pa ndryshkshem

Mbulesa gasket O-ring

Porta NBR ose EPDM gome

Bullonat dhe dadot Stainles celik i pa ndryshkshem

Operimi me dore

12.4 Saracineskat e Reduktimit te Presionit

Saracineskat qe do te projektohen pa komponente te vogla kalimi do te jene te preferuara.

Saracineskat e preferueshme do te jene ato per hapje te medha per prurjen e ujit. Te gjitha dimensionet e pasazheve te tilla do te jene te mbrojtura me filtra. Izoluesi I saracineskave do te instalohet per lejimin e pastrimit te filtrit.

Dimensionet e saracineskave sipas vizatimeve te Kontraktorit. Flanxhat dhe birat sipas DIN 2501.

Provat e vrodhuesit

Provat hidraulike:

Kapaciteti:

1,5 here PN dhe vakum I plote. Kapaciteti i saracineskave sipas kushteve te specifikuara do te



jete provuar dhe do te jete leshuar nje certificate prove.

Funksioni provave

Funksioni i rregullimit te presionit te saracineskave do te jete provuar brenda presionit te punes dhe jashte presionit te punes (-1) den 16 bar. Aprovuar nga DVGW ose te ngjashem.

Aprovimet:

Cilesia e Materialeve te meposhtme ose te krahasueshme. Materialet do te jene rezistente nga korrozioni ne kushte te mesme dhe te ambientit.

Trupi i saracineskes	Gize, GG-25 sipas DIN1691
Seat Saracineskes	Celik i pandryshkshem me rezistence te larte.
Seat seal	NBR (Nitrile)
Plugs	Celik i pandryshkshem, EPDM
Membrane	Nitril i armuar
Position treguesit	Celik i pandryshkshem
Gasket	Grafit
Dadot dhe Bullonat	Celik i pandryshkshem
Manometrat per matjen e presionit ne hyrje dhe ne dalje.	
Veshja e jashtme	Electroccally aplikuar epoxy 200my.

12.5 Pjeset Bashkuese

Flanxhat do te jene sipas DIN 2501. Materiali St. 37.2 sipas DIN 17100. Spesori sipas kerkesave te mesiperme per trashesine e tubave.

Komponentet do te jene ekspozuar ne vakum te plote dhe do te provohen per presion operimi ndermjet vakumit te plote dhe 16 bar.

12.6 Strainer

Filtrat do te jene te qendrueshem per mbrojtjen mekanike te presionit te saracineskave, kunder korrozionit.

Provat e prodhuesit Provat hidraulike:

1,5 here PN dhe vakum i plote

Materialet:

Trupi: Gize, GG25 to DEN 1691

Filtrat: Filtrat duhet te jene te nderrueshem. Filtrat duhet te pastrohen.

Celik i pandryshkshem AISI316.

Dadot dhe Bullonat Celik i pandryshkshem AISI316.

Veshja e jashtme Electroccally aplikuar epoxy 200my.

12.7 Manometrat

Gradimi I shkalles se presionit rrotull 1%

Matesi i presionit do te aprovohet nga prodhuesi me nje saktesi $\pm 2\%$. Do te jete i paisur me saracineske izoluese.

Te gjithë matesat do te kene njehsor koncentrik minimumi me diameter 100mm. Matesi i presionit do te gradohet ne bar. Njehsori do te kete nje tabele ku te shenohet ne gjuhen Shqipe:

“E RENDESISHME, MBYLLE KUR NUK ESHTË NE PERDORIM”

Te gjithë diametrat, trashesite, atesat do te jene provuar nga prodhuesi dhe certifikata e proves do te jete per cdo njerën.

Te gjitha materialet do te jene celik I pandryshkshem AISI316.

12.8 Bullonat, dadot, shpelaresit

Bullonat per fllanxhat lidhese do te kene fileto metrike, numri dhe dimensionimi sipas DIN 2501, bullona celiku-ISO4014, galvanizuar ne te nxehte – ISO1461.

Shpelaresit-DIN934, galvanizuar ne te nxehte -ISO1461.

Dadot-DIN 125B, galvanizuar ne te nxehte-ISO1461.

12.8 Packing and Gaskets

Gaskets per lidhjen e fllanxhave do te jene gome e armuar EPDM .Min 3mm.

13 Lyerja dhe mbrojtja e metalit

Tubat dhe saracineskat duhet te lyhen nga jashte sipas specifikimeve te meposhtme:

Te gjitha lyerjet e demtuara nga Kontraktori, gjate punes se tij, do te riparohen.

Te gjitha paisjet prej celiku xingato duhet te jene te ljera ose te mbrojtura nga korrozioni. Ruajtja e siperfaqeve do te behet sipas klasifikimit te ISO 12944-2, rezervuari eshte klasifikuar si zone e pa ngrohur me mundesi kondensimi. Kontraktori do te specifikojë siperfaqet e vecanta ku duhet te aplikohet mbrojtja, metoda e aplikimit, trashesia e lyerjes, cilesia e lyerjs, densiteti i poreve. Te gjitha lyerjet dhe provat e lyerjes do te ekzekutohen sipas standarteve te specifikuara nga Kontraktori.

14 Provat e presionit te tubacioneve

Kontraktori do te siguroje te gjithë ujin, rakorderite, saracineskat, pompat e proves, aparatit e presionit dhe krahe pune dhe veglat e punes te nevojeshme per provat e tubacioneve. Pajisjet e proves duhet te jene mbajtur ne rregull dhe te kalibruara me aprovimin e Inxhinierit. Provat duhet te jene te aplikuar ne seksionet e tubacioneve; gjatesite e tilla do te percaktohen ne marreveshje midis Inxhinierit dhe Kontraktorit.

Presioni I tubacioneve do te jete testuar prej nje test hidraulik. duke perdorur uje prej nje burimi te aprovuar, ne nje presjon $1 \frac{1}{2}$ here me shume se maksimumi i presionit normal te punes. Fundi i seksionit qe do te testohet do te jete I mbyllur, duke perdorur pjese te pershtateshme te ankoruar ne menyre te pershtateshme. Tubacioni duhet te jete mbushur me uje ne menyre te ngadaleshme,



dhe do te jete nen vezhgim per ndonje rrjedhje ne nje minimum te presionit statik per 24 ore. Ne se nuk ka ndonje rrjedhe presioni do te rritet gradualisht deri ne presionin e kerkuar te proves dhe do te mbahet ne kete presion prove per nje minimum 4 oresh, per te lejuar nje inspektim te detajuar nga Inxhinieri. Per 2 oret e tjera me pas, humbjet e ujit, do te regjistrohesh sic maten prej sasise se thithjes se pompes per te mbajtur presionin e testimit. Kjo nuk do te jene ne 0.1 litra per mm DN per kilometer te tubit per 30m WG te presionit te testit per 24 ore.

Te gjitha difektet do te jene te identifikuara dhe do te riparohen me shpenzimet e Kontraktorit. Testi do te perseritet deri sa te merret nje rezultat i kenaqshem. Ne shtese te testeve ne seksion, i gjitha tubacioni do te testohet me te njejten presion dhe me te njejten procedure.

15 Provat e Komponenteve

Te gjitha funksionet e komponenteve do te provohen per te gjitha proceset e operimit.

16 Pastrimi dhe sterilizimi

Tubat me presion do te pastrohen me tampon e me shkume tamponuese; pastrimi do te vazhdoje deri sa uji te dale i paster. Gjate ndertimit, te gjitha tubacionet do te mirembahen ne kushte te pastra dhe tape druri ose te tjera mbyllje te aprovuara do te futen ne tubat e hapura ne fund te cdo dite.

Tubacionet per furnizimin me uje do te jene te sterilizuara pas pastrimit dhe para perdorimit.

Tubacionet do te mbushen me uje te paster me klor mbetse ne sasine 50 mg/l; kjo mbetje mund te arrihet prej shtimit te perberjes se klorit ose klor gaz ne ujin e mbushur. Tubacioni duhet te jete i mbushur per nje periudhe 12 oresh dhe testi i klonit do te kryhet ne 5 (pese) kampjone te ujit te marra ne piken me te larget nga pika e aplikimit te klorit. Ne se klori i mbetur ne te gjitha kampjonet eshte ne nje shkalle 10 mg/l, atehere tubacioni do te konsiderohet si i sterilizuar. Uji perfundimtar do te futet ngadale ne te njejten kohe si uji i pasur me klor ka terhequr papastertine. Uji i papaster do te shkarkohet ne nje rrjedhje uji te afert ose kanal kullimi te afert, te miratuar nga Drejtuesi i Projektit.

17 Punime dheu

Punimet e dherave do te jene ne vendin, linjen, nivelin dhe dimensionet sic tregohet ne Vizatime, ose perndryshe sic instruktohet nga Supervizori. Kontraktori duhet te dorezoje tek Supervizioni per aprovim, para se te filloje punime dherash, nje pershkrim te detajuar te metodet dhe kombinimeve te cilat kontraktori propozon te perdore.

Kanalet do te jene te germuara ne nje gjeresi minimale te pajtueshme me instalimin e sigurte te tubave dhe te rakorderive. Minimumi i mbulimit te tubave, llogaritet prej siperfaqes se tokes tek kufiri i siperm i tubit, dhe do te jete:

- 800 mm ne kopesht etj.
- 800 mm ne kalim kembesoresh
- 800 mm permes tokave bujqesore
- 900 mm ne rruge

Shtirja e tubave ose vendosja e shtresave te fundit te shtratit (nese kerkohet) nuk do te filloje

deri sa fundi i kanalit te jete i kontrolluar dhe inspektuar nga Inxhinieni.

Materialet e germimit te kanalit do te ruhen veçan, me qellim I heqje, keshtu qe rimbushja e kanalit mund te behet ne menyre metodike pasi te jete kryer prova e tubave. Mbushja e tubave mbi dhe rreth tyre, do te behet vetem pas daljes me sukses te provave te tubacioneve; mbushja nuk do te behet ne se kanali permban uje. Ne kanalet ne fushe ose ne vende te hapura, materialet mbushese do te vendosen ne shtresa 300mm(trashesi e ngjeshur) nga makineri, duke siguruar qe materialet te vendosen me rrotullim ose me rreshqitje dhe jo te hedhur me force direkt mbi tubacion. Kanalet ne rruge duhet te mbushen me shtrese 200mm (trashesi e ngjeshur) dhe e kompaktuar ne 93% MoD AASHTO; shtresa e fundit 300 mm do te jete e materialeve zhavorre, e pershtateshme per rruge, e kompresuar 98%MoD AASHTO. Materialet mbushese nuk duhet te kene asnje gure ose ndonje material tjeter te forte qe ka dimensione 150mm, ne asnje drejtim.

Nje hapësire e mjaftueshme duhet te lihet per te marre nje trashesi origjinale te tokes, torfes, te siperfaqes se rruges ose ndonje materiale te tjera te cvendosur nga siperfaqja. Siperfaqet do te ristrukturohen duke rivendosur materialet ne menyren dhe formen e duhur, dhe ne nje nivel te tille qe te mund te sigurojne qe pas uljes eshte complete, dhe siperfaqja e kanaleve te rimbushura do te jete brenda 20 mm, per rruget dhe rruget e kembesoreve (50 mm per fushat). Uljet qe kalojne keto toleranca do te cojne ne shtesen e Periudhes se Garancise se Difecteve me shpenzimet e Kontraktorit.

Kanalet ne siperfaqe te asfaltuar dhe rruge kembesoresh do te jene te sistemuara me materiale te njejta si siperfaqja origjinale e shtruar pasi Inxhinieri ka rene dakort qe ri instalimi eshte kompletuar. Anet e risistemimit do te priten ne vija te drejta para se te jepet dora e fundit e rregullimit.

18 Shtrati dhe Rrethimi

Shtrati dhe rrethimi do te jete natyral, me material zhavorri, sic tregohet ne vizatimet. Atje ku eshte e mundur, do te perdoren materialet e zgjedhura nga germimi, dhe te hiqen guret me madhesi mbi (>35mm) ose ndonje objekt tjeter I forte. Te gjithë materialet do te vendoset dhe do te ngjeshen me dore ose me ngjeshes mekanik te pershtatshem; asnje material nuk do te vendoset ne kanalet me prezence uji. Materialet do te vedosen ne shtresa me trashesi jo me te madhe se 150mm (te ngjeshura)

dhe te kompaktuara ne densitetin 1 800 kg/m³.

Atje ku specifikohet, shtrati do te jete i gjithë gjerësia e kanalit dhe do te perfundoje ne nje siperfaqe te sheshte dhe te rafshite, ne nivelet dhe gradat e caktuara, kavitate te pershtateshme do te lihen ne shtrat, ne se eshte e nevojeshme per te akomoduar metodat e lidhjes dhe materialet. Mbushja do te behet ne dy drejtime te tubacionit dhe do te ngjishet me takmak te pershtateshem me dore. Lidhjet e tubacioneve nuk do te mbulohen derisa prova e ketij seksioni tubi te behet me sukses. Materialet mbushese do te vendoset mbi tubacion sipas nje trashesie te treguar ne vizatime.

Fundi i kanalit nuk mund te jete me pak se 40-cm+ I diametrit te jashtem. Ne cdo rast gjerësia duhet te jete e mjaftueshme te lejoje pergatitjen korrekte te tubave, te shtratit te tubave dhe aksesoreve te tubave brenda ne kanal. Fundi i kanalit duhet te jete i qendrueshem.

Perpara shtrirjes se tubave duhet te vendoset nje shtrese rere ne fund te kanalit, trashesia e se



ciles nuk mund te jete me pak se $(10+De/10)$ cm, (De- diametric I jashtem), me nje minimum absolut 15 cm. Mbas shtrirjes se tubave duhet te mbulohen me rere. Trashesia e reres duhet te matet ne pjesen e sipërme te tubit dhe nuk duhet te jete me pak se 20 cm. Si rregull i pergjithshem tubat duhet te mbulohen minimumi 130 cm, nqs jo, tregohet ne vizatim.

19 Tubacionet e vendosura permes strukturave

Kur tubat kalojne permes strukturave, 2 (dy) lidhje fleksibile te aprovuara do te merren ne tubacionet e jashteme, sic tregohet ne vizatime. Siperfaqja e jashteme e tubave e ndertuar ne mure do te kene veshjen mbrojtese te tyre te jashtme, (ne se ndonje) te hequr per trashesine e murit.

Manikotat e veshura me argjile, duhet te vendosen atje ku tubi peneron strukturen ne nivelin e ujrave nentokesore, ose poshte niveleve operationale te poshtem te ujit ne struktura qe permbajne uje.

20 Materialet dhe fuqia punetore -Betoni

20.1 Kerkesa te

Pergjithshme

Te gjitha punimet e betonit do te kryhen ne perputhje me BS 8110/85 (Pjesa e 1); per strukturat qe mbajne uje, punimet e betonit do te projektohen dhe ndertohen ne perputhje me BS 8007/87.

20.2 Cimento

Cimento do te jete cimento e zakonshme Portland, qe te plotesoje kerkesat e BS 12/91 ose standarte te aprovuara te ngjashme qe do te jene te dhene nga prodhues me reputacion dhe te aprovuara nga Inxhinieri. Cimento duhet te sillet ne objekt dhe te perdoret nga Kontraktori vetem me konsensus me shkrim te Inxhinierit, te bazuar ne rezultatet e certifikatave te testit te marra nga nje laborator i aprovuar. E gjithë cimento qe per ndonje arsye eshte bere pjeserisht e bashkuar ose permban kokrra ose cimentoja e mbrujtur do te kthehet dhe do te largohet nga Objekti.

Per cdo parti te sjelle ne objekt, Kontraktori do te dorezoje tek Inxhinieri nje vertetim me shkrim ku te tregohet numri i partise te shkarkuar, emri i prodhuesit dhe numri i thaseve ose te eneve mbajtese dhe nje certifikate te testit respektiv. Vertetimi duhet gjithashtu te tregojë ku ngarkesa do te ruhet ne objekt. Ne shpermdarjen ne objekt, cimento do te ruhet ne nje mjedis te pershtatshem te thate dhe te ventiluar mire ose ne silloza me mbrojtës nga uji, kjo duhet te behet nga Kontraktori dhe te aprovohet prej Inxhinierit.

Nje kujdes I madh duhet te behet ne sigurimin e nje dysHEMEJE te thate prej druri ose betoni per cdo magazine ne menyre qe te shmangen reziqet e demtimit te cimentos nga dysHEMEJA. Te gjitha thaset e cimentos do te ruhen ne dysHEME te thate dhe te ventiluar mire. Cimento nuk duhet te perdoret pa lejen e Inxhinierit dhe cdo ngarkese do te perdoret ne menyre te vetme dhe ne rend kronologjike te sjelle ne kantier, ose sic mund te drejtohet nga Inxhinieri.

Cimento nuk do te perdoret pasi te ruhet ne objekt per me shume se 3 (tre) muaj.

20.3 Inerttet

Agregatet per betonin do te plotesojne ne te gjithë aspektet BS 882/92, dhe Kontraktori do te testoje kampjonet sic pershkruhet ne Bs 812, sic kerkohe nga Inxhinieri.

Agregatet e trasha dhe te imta per betonin do te plotesojne BS 882/92 dhe shkalla e tyre do te jete ne perputhje me Tabelen 3 dhe respektivisht me tabelen 4. Agregatet e imta natyrisht do te jete rera. Agregatet e trasha do te jene gure i thermuar ose, ne se aprovohe nga Inxhinieri, zhavorr aluvial. Agregatet do te jene te forta, te durueshme dhe te pastra dhe nuk do te permbajne materiale qe mund te ndikojne keq ne fortesine dhe durueshmerine e mases se betonit te armuar.

Madhesia dhe porcioni i madhesive te ndryshme te agregatese do te jete brenda limiteve te vendosura ne BS 882/92, po qe se nje modifikim i nje limiti te tille eshte i aprovuar nga Inxhinieri. Ne cdo pike ku betoni eshte bere, agregatet do te ruhen ne nje zone te vecante, keshtu te rregullohet si te parandalohet perzierja e masave te tyre te ndryshme. Magazina do te jete e pershtateshme te mbroje kontaminimin e agregateve nga dheu, plehra, gjethe, pluhur ose te tjera materiale jo te rendesishme. Cdo agregat i kontaminuar nuk do te perdoret ne Punime, dhe shtresa e fundit prej 300 mm e materialeve do te perdoren vetem ne qofte se do te aprovohen prej Inxhinierit. Keto materiale duhet te jene ne gjendje te bejne nje kullim te mire.

Agregatet e kerkuara per perdorim ne ndertim te betoneve per mbajtje uji dhe strukturat e tjera te ngjashme nuk do te absorbojne me shume uje se 2% e peshes se tyre, kur drenohet per 24 ore.

20.4 Uji

Uji per perzjerjen e betonit duhet te jete i fresket, i paster dhe i lire nga vajrat, acidet, alkalitet, ndotjet, mineralet e demshme ose materiale organike.

Inxhinieri do te kerkoje testimin e ujit, ne perputhje me kerkesat e BS 3148/80, per te gjithë burimet e pa aprovuara te ujit. Uji nuk duhet te permbaje klor dhe sulfatet me teper se 600 miligram/liter. Ai nuk do te permbaje pisllice ne ate sasi qe mund te shkaktoje nje rritje te kohes se prezes te Cementos te Zakonshme Portland te me shume se 25% dhe as zvogelim te saj me shume se 5% te krahasuar me rezultatet e marra nga uji i distiluar. Uji per betonin duhet te kete nje pH me te madhe se 5 dhe nuk duhet te permbaje pisllice te nje sasive te mjaftueshme qe mund te shkaktoje shngjyrimin e betonit. Kontraktori duhet te siguroje qe te gjithë tubat, rezervuare dhe konteneret per mbajtjen e ujit me qellim perdorimin e perberesve te betonit te ruhen ne kushte te pastra.

20.5 Armimi

Hekuri per armim do te plotesoje standartet e meposhtme, si :BS

5896/80, 4449/89, 4483/85. Shufrat e sheshta, te rrumbullakta, te hekurit duhet te kene nje minimum te pikes se durimit ne terheqje 250 N/mm². Deformimi i shufrave te armimit do te thote te perdoren shufra te rrumbullakosura me nxehtesi te nje durimi fortesie te larte. Ato duhet te kene nje minimum te kufirit te durimit ne terheqje 410 N/mm² dhe nje fortesie lidhjeje te pakten 4% mbi ate te shufrave te zakonshme te rrumbullakta. Ne se aprovohen nga Inxhinieri, shufra te perdredhura ne te ftohte mund te perdoren prej Kontraktorit. Rrjete e celikte e salduar do te jete ne perputhje me kerkesat e BS 4482/85 dhe BS 4483/85.

Te gjithë shufrat duhet te shperndahen ne zone te lidhura forte se bashku ne tufa, me gjatesi, diameter dhe numer te treguar qartesisht. Kur shufrat te jene te prera dhe te lidhura jane shperndare ne zone, tufat e shufrave te



27

ngjashme do të jenë të lidhura së bashku dhe shënuar me një shenjë që tregon shenjën e shufrës dhe sasinë. Inxhinieri do të zgjedhë monstrat e shufrave të armimit për të bërë provën nëse të dhenat e provave nuk janë dhënë nga Kontraktori. Rezultatet e një testi të tillë do të konsiderohen si rezultatet e të gjithë ngarkesës. Shufrat e armimit duhet të ruhen në zonë mbi dysheme dhe duhet të mbrohen me materiale kundër ndryshkut, demtimeve vajit ose agjenteve të tjera shkatërrues.

